

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.15

Prill 2022



VETËM NJË SHOQËRI E SHËNDOSHË DEMOKRATIKISHT MUND TË PRODHOJË DREJTËSI TË SHËNDOSHË DEMOKRATIKISHT

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Sfidat aktuale të sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe proceset e demokratizimit”, organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Në fjalën e tij me temë “Nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi gjyqësore”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se hapja e

negociatave të antarësimit është një sfidë historike për ne dhe përballë këtij synimi jemi të vetëdijshëm për nevojën që modeli ynë i shtetit të së drejtës duhet të jetë i krahasueshëm me vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ndaj, reformën në drejtësi e kemi renditur si një prioritet kryesor, jo thjesht si një detyrim politik përpara Bashkimit Evropian, por më së shumti si një vlerë shoqërore e themelore për zhvillimin e



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Z. METANI:

“Shqipëria është një vend që aspiron anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe aktualisht jemi në fazën e diskutimit për hapjen e negociatave me të. Është një sfidë historike për ne dhe përballë këtij synimi jemi të vetëdijshëm për nevojën që modeli ynë i shtetit të së drejtës duhet të jetë i krahasueshëm me vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ndaj, reformën në drejtësi e kemi renditur si një prioritet kryesor, jo thjesht si një detyrim politik përpara Bashkimit Evropian, por më së shumti si një vlerë shoqërore e themelore për zhvillimin e Shqipërisë.”



Shqipërisë.

“Prandaj, – tha Z. Metani, krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur është sfida kryesore e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, pasi është parakusht për sundimin e ligjit dhe thelbësor për funksionimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Një nga sfidat kryesore të organeve të reja të sistemit të drejtësisë ka qenë dhe mbetet krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur. Synimi është reformimi i sistemit në atë menyrë që të funksionojnë mekanizma të qëndrueshme për spastrimin e sistemit nga elementet abuzues me ligjin dhe detyrën, por njëherësh edhe të garantojnë forcimin e mëtejshëm të pavarësisë dhe lirisë kushtetuese të sistemit gjyqësor, pasi pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave qëndron në themel të mirëfunksionimit ose jo të një shteti demokratik. Pavarësia është parakusht i sundimit të ligjit.”

Duke bërë dallimin mes “pavarësisë de jure”, si ekzistenca formale e parashikimeve ligjore dhe “pavarësisë de facto”, e cila lidhet me zbatimin të tyre, Z. Metani tha se funksionimi në praktikë varet mes të tjerash edhe nga kultura gjyqësore e një vendi, besimi në legjitimitimin e sistemit gjyqësor dhe përkushtim real ndaj këtij

standardi.

“Pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk mund të garantohet, nëse nga ana e një shoqërie apo sistemi politik nuk ka vullnet për krijimin e një fryme stabiliteti dhe demokracie. Pavarësia e pushtetit gjyqësor kërkon përfundimisht një kontekst dhe mentalitet jo autoritar. Përfundimi se “Nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi gjyqësore” mund të jetë zhgënjyes në pamje të parë, por ky përfundim argumenton qartë, se demokracia dhe sundimi i ligjit janë të lidhura bashkë.” – tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

“Për këtë, – vijoi Z. Metani, duhet ndërtuar besueshmëri dhe për ta ndërtuar atë besueshmëri, patjetër duhet siguruar një kulturë llogaridhënieje e sistemit të drejtësisë. Në demokraci drejtësia jepet në emër të qytetarëve. Besimi i publikut është i domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe ky legjitimin kërkon angazhimin e magjistratëve për të ruajtur këtë besim. Prandaj vlen të theksohet se pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk duhet të shihet si një privilegj i magjistratëve, por si një e drejtë e qytetarëve.”- tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë në fjalën e tij.

FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, Z. ARTUR METANI NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare të zhvilluar, me temë “Sfidat aktuale të sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe proceset e demokratizimit”.

Fjala e plotë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e mbajtur në Konferencë.

I nderuar Prof. Angjeli,

Të nderuar akademikë, profesorë dhe studentë,

Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës,

Ju falënderoj për ftesën dhe për mundësinë që më dhatë të shpreh mendime në lidhje me një çështje me interes për zhvillimin e vendit. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është një kënaqësi e dyfishtë.

Së pari, sepse vlerësoj se zhvillimi i saj, si dhe diskutimi në nivel akademik lidhur me sfidat

**Nuk ka pavarësi
gjyqësore pa
demokraci dhe nuk
ka demokraci pa
pavarësi gjyqësore!**

aktuale të proceseve demokratike dhe sistemit gjyqësor në Shqipëri, përbën në vetvete një proces të rëndësishëm.

Sigurimi i një mendimi të kualifikuar profesional, mbështetur në një eksperiencë teorike dhe praktike të studiuesve të së drejtës, përbën një kontribut kyç në procesin e analizimit të plotë të gjendjes aktuale. Në të njëjtën kohë, ky proces angazhimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar juridik shërben edhe si një mekanizëm për evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim.

Kontributi i botës akademike përfaqëson në këtë moment një fazë të rëndësishme për vazhdimin e ndërhyrjeve reformatore, që janë ndërmarrë deri më tani në sistemin e drejtësisë. Kjo, pasi jo vetëm që krijon një frymë gjithëpërfshirëse nëpërmjet angazhimit të të gjithë aktorëve të shoqërisë, siç është ndër të tjera edhe bota akademike, por njëkohësisht provokon edhe një debat të

dobishëm, i cili ndihmon pozitivisht ecurinë e zhvillimit të pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Së dyti, aktiviteti i sotëm është një mundësi e mirë për të diskutuar për një çështje me rëndësi themelore për modelin e shtetit të së drejtës, për një sistem drejtësie të pavarur dhe profesional dhe ndikimin apo ndërlidhjen që ka ky proces me zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Ajo që dëshiroj të diskutoj sot, ka për qëllim të ngrejë paraprakisht disa teza me qëllim provokimin e mendimit, të cilat në këndvështrimin tim janë sa konceptuale aq edhe sistemike, në lidhje me një sërë çështjesh, të cilat kanë të bëjnë me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, analizuar kjo në raport me demokracinë, sistemin gjyqësor apo vetë shtetin e së drejtës.

Njëherazi, dëshiroj të shpreh edhe disa konsiderata apo ndjesi personale, që vijnë jo vetëm nga optika dhe përvoja në fushën e së drejtës, por edhe në cilësinë e drejtuesit të njërës prej institucioneve më të reja, të konceptuara dhe të ngritura në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Shqipëria është një vend që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe aktualisht jemi në fazën e diskutimit për hapjen e negociatave me të. Është një sfidë historike për ne dhe përballë këtij synimi jemi të vetëdijshëm për nevojën që modeli ynë i shtetit të së drejtës duhet të jetë i krahasueshëm me vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ndaj, reformën në drejtësi e kemi renditur si një prioritet

kryesor, jo thjesht si një detyrim politik përpara Bashkimit Evropian, por më së shumti si një vlerë shoqërore e themelore për zhvillimin e Shqipërisë.

Një nga sfidat kryesore të organeve të reja të sistemit të drejtësisë ka qenë dhe mbetet krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur.

Synimi është reformimi i sistemit në atë mënyrë që të funksionojnë mekanizma të qëndrueshme për spastrimin e sistemit nga elementet abuzues me ligjin dhe detyrën, por njëherësh edhe të garantojnë forcimin e mëtejshëm të pavarësisë dhe lirisë kushtetuese të sistemit gjyqësor, pasi pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave qëndron në themel të mirëfunksionimit ose jo të një shteti demokratik. Pavarësia është parakusht i sundimit të ligjit.

Megjithatë, paraprakisht vlerësoj se demokracia apo koncepti i shtetit të së drejtës janë koncepte dinamike dhe komplekse. Veçanërisht në vende me demokraci në zhvillim, si ky i yni, kërkohet shumë më tepër se pavarësia de jure, pra jo thjesht ekzistenca formale e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Pavarësia de facto është ajo që kërkon kohë dhe shumë



përpjekje. Funksionimi në praktikë i këtyre dy koncepteve, varet nga disa faktorë, si:

Së pari: Mënyra se si garantohet pavarësia e gjyqësorit varet nga kultura gjyqësore e një vendi, e cila pasqyron përvojat e tij të veçanta historike, në raport me rrethanat politike apo sociale. Pavarësia e pushtetit gjyqësor mund të shoqërohet me ndryshime strukturore, institucionale dhe ligjore, por ajo mund të ketë sukses vetëm kur shoqëria e një vendi të ketë besim në legjitimin e pushtetit gjyqësor dhe të tregojë një përkushtim real ndaj këtij standardi.

Së dyti: Pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk mund të garantohet, nëse nga ana e një shoqërie apo sistemi politik nuk ka vullnet për krijimin e një frymë stabiliteti dhe demokracie.

kësaj pavarësie kërkon një nevojë të vazhdueshme për t'iu përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të reja të mbrojtjes së këtij standardi. Nëse përpjekjet për një infrastrukturë kushtetuese e ligjore, fizike gjithashtu, për një arkitekturë të re të sistemit të drejtësisë morën disa vite, përpjekja për krijimin e një mentaliteti demokratik të një gjyqtari të paanshëm, respektimit rigoroz të ligjit dhe të të drejtave të njeriut, kërkon shumë më tepër kohë dhe shumë më tepër energji.

Së katërti: Krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur kërkon një përpjekje të vazhdueshme nga ana e shtetit dhe qytetarëve për zbatimin e ligjit dhe të koncepteve të së drejtës. Demokracia dhe shteti i së drejtës janë koncepte që edukohen dhe ushqehen në familje, që në gjenezën e

Pavarësia e pushtetit gjyqësor kërkon përfundimisht një kontekst dhe mentalitet jo autoritar. Përfundimi se “Nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi gjyqësore” mund të jetë në pamje të parë dekurajues dhe i largët, por përvoja botërore dhe historia jonë kanë treguar qartë se demokracia dhe sundimi i ligjit nuk mund të funksionojnë ndryshe përveç se bashkë.

Së treti: Procesi i sigurimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Sigurimi i



saj, në shoqëri dhe mjedise akademike. Vetëm një shoqëri e shëndoshë demokratikisht mund të prodhojë drejtësi të shëndoshë demokratikisht.

Së pesti: Pavarësia e sistemit gjyqësor nuk është një koncept absolut. Pavarësia dhe besimi që shoqëria i jep magistratëve janë të tilla, që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim. Duhet pranuar se rritja e



kompetencës dhe pavarësisë së magistratëve duhet të shoqërohet me një sistem llogaridhënës efektiv. Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi.

Në rastin konkret duhet të ekzistojë një proces i vazhdueshëm i balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Ky proces duhet të karakterizohet nga veprimi dhe kundër reagimi në të njëjtën kohë. Sa më shumë kompetenca të zotërojë pushteti gjyqësor, aq më të larta duhet të jenë kërkesat për llogaridhënie.

Në të njëjtën kohë, niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut apo perceptimi publik shërben si një tregues i rëndësishëm mbi balancën që duhet të ekzistojë ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor.

Në rastet kur besimi i publikut është i ulët, atëherë tregon se pavarësia e magistratëve ka

prevaluar mbi sistemin llogaridhënës, ndërsa në rast se besimi i publikut është i lartë, atëherë ky është një tregues i qartë mbi ekzistencën e një ekuilibri të drejtë, ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies.

Për të ndërtuar besueshmëri, patjetër duhet siguruar një kulturë llogaridhënieje e sistemit të drejtësisë. Në demokraci drejtësia jepet në emër të qytetarëve. Besimi i publikut është i domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe ky legjitimim kërkon angazhimin e magistratëve për të ruajtur këtë besim. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk duhet të shihet si një privilegj dhe mburojë e magistratëve, por si një e drejtë e qytetarëve.

Shqipëria ka treguar se është në reformim të vazhdueshëm për të vendosur stabilitet dhe garanci demokratike. Zbatimi i reformës në drejtësi është një proces që vazhdon. Unë çmoj se reforma në drejtësi ka ngritur kapacitetet e sistemit të drejtësisë dhe po jep rezultate konkrete dhe rezultatet e arritura tregojnë ndryshim.

Megjithatë, krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur në përputhje me standardet demokratike dhe shtetin e së drejtës kërkon kohë dhe energji nga të gjithë, gjyqtarët e prokurorët, institucionet e reja të drejtësisë, por edhe vetë politika dhe shoqëria.

Faleminderit dhe ju uroj suksese!

Videon e plotë të fjalës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund ta ndiqni në kanalin zyrtar Youtube.

SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë takimit të Sektorit me ankues

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.


Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.



Gjatë muajit *Prill 2022*, Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave ka pritur 22 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 39 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

TAKIME DHE TELEFONATA ME ANKUES

- Takimet me ankues
- Telefonata nga qytetarët



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA PËR 4 MUJORIN E PARË TË VITIT 2022

Në katër mujin e parë të këtij viti, Janar-Prill 2022, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **50 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

Për **vitin 2022** janë trajtuar mesatarisht **3 ankesa në javë** nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Konkretisht të dhënat sipas muajve:


Janar - 12 kërkesa nga persona fizikë;

Shkurt- 14 kërkesa ,prej të cilave 12 nga persona fizikë dhe 2 nga persona juridikë;

Mars - 12 kërkesa, prej të cilave 11 nga persona fizikë dhe 1 kërkesë nga një person juridik;

Prill - 12 kërkesa nga persona fizikë.

KËRKESAT PËR INFORMACION SIPAS MUAJVE NË %



SI KA QENË ECURIA E PUNËS NË ILD NË TRE MUJORIN E PARË TË KËTIJ VITI?

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2022, **Janar-Mars**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 198 ankesa në total.

ILD ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion.

Konkretisht këto shifra përkthehen në Statistika të prodhura nga Sektori i Arkiv-Protokollit:

198 Ankesa të depozituara pranë ILD, nga të cilat 194 nga qytetarët dhe 4 nga institucionet;

324 Vendime arkivimi nga të cilat:

234 Vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;

28 Vendime arkivimi pas verifikimit (të ardhura në ILD);

62 Vendime arkivimi pas verifikimit (të trashëguara nga ish-KLD);

436 Ankesa të trajtuara në 324 Vendime;

49 vendime verifikimi;

3 Vendime për fillim hetimi disiplinor;

1 Vendim për mbyllje hetimi disiplinor (për 3 subjekte);

1 Vendim pezullim hetimi.



ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për confirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD -së www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

STATISTIKA MUJORE

Gjatë muajit **Prill** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **67 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarët.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer confirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Prill 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

PRILLI I ILD NË SHIFRA

102 vendime arkivimi nga 147 ankesa të shqyrtuara:

- * 75 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
- * 16 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- * 11 vendime arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD;
- * 13 vendime verifikimi;
- * 1 vendim për mbyllje hetimi (vazhdim hetimi disiplinor i nisur nga ish KLD).

VEPRIMTARIA E ILD NË RAPORTIN E DASH MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2021



Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin vjetor mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri për vitin 2021. Në seksionin e respektit për integritetin e individit, paraqitet situata dhe veprimtaria e institucioneve në zbatim

të reformës në drejtësi. Në raport jepen edhe disa rezultate të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të trajtimit të ankesave, hetimit dhe procedimit disiplinor.

“Zbatimi i ligjeve të reformës në drejtësi çoi në një pauzë në proceset normale disiplinore ndërkohë që vendi krijoi organe të pavarura disiplinore.”

Nga Janari deri më 8 Shtator, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vend ka marrë 875 ankesa që kanë rezultuar në dhënien e 740 vendimeve për arkivim dhe 120 vendimeve për verifikimin e ankesave. Gjithashtu, ka administruar 24 hetime disiplinore, nëntë prej të cilave ishin transferuar nga Inspektorati i mëparshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur edhe nëntë kërkesa për procedim disiplinor ndaj magjistratëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.”, thuhet në Raport.

Lidhur me procedurat dhe mjetet juridike civile për të trajtuar mes të tjerash shkeljet dhe rastet e korrupsionit apo jo, eficientës në gjyqësor, në Raport nënvizohet kontributi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes mekanizmave ligjorë në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së magjistratëve, konkretisht:

“...Procesi në vijim i vetingut dhe mekanizmat ligjorë të vendosur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të rregulluar disiplinimin e magjistratëve synojnë gjithashtu zbutjen e problemeve të tilla.”

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi praktikën e të drejtave të njeriut është një publikim vjetor që paraqet kushtet e të drejtave të njeriut në vende dhe rajone jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës e që paraqitet çdo vit nga Byroja e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës.

VEPRIMTARIA E ILD NË RAPORTIN E DASH MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2021 ILD-KLP KOORDINIM PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE UNIFORME TË PROCEDIMIT DISIPLINOR



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani priti në një takim pune kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Z. Alfred Balla.

Duke e uruar për detyrën e re, Z. Metani i shprehu kryetarit të KLP-së besimin se bashkëpunimi mes dy institucioneve do vijojë, në drejtim të vendosjes së standardeve më të mira të procedimit disiplinor, si një mënyrë jo thjesht për të ndëshkuar, por edhe për të edukuar magjistratët për të qenë në lartësinë e detyrës, si kontributorë të rëndësishëm në kthimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë u dakordësuan për të vijuar komunikimin institucional në adresimin e problematikave me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve.

VEPRIMTARIA E ILD NË RAPORTIN E DASH MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2021 INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON DREJTUESEN E KOMISIONIT PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT TË ARMENISË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani priti në një takim pune drejtuesen e Komisionit për Parandalimin e korrupsionit të Armenisë, Zj. Haykuhi Harutyunyan me delegacionin shoqërues.

Në fokus të bisedës ishte reforma në drejtësi që po zbatohet në Shqipëri dhe roli i institucioneve të reja të dala prej saj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani e njohu delegacionin armen me funksionet dhe ecurinë e punës së Zyrës së ILD-së dhe iu përgjigj pyetjeve mbi procesin e ankimimit, inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.



Prill 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani](#)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](#)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD